



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

SHPLLJE PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË LIRË PËR KATEGORINË E MESME DREJTUESE

Drejtore i Drejtorisë së Planifikimit të Frekuencave dhe Teknologjisë së Informacionit

Në zbatim të nenit 26 të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, i ndryshuar, Autoriteti i Mediave Audiovizive shpall procedurat për plotësimin e vendit të lirë të kategorisë së mesme drejtuese:

**- Drejtore i Drejtorisë së Planifikimit të Frekuencave dhe Teknologjisë së Informacionit -
Kategoria e pagës II-b**

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është vakant, ai është i vlefshëm për nëpunësit civilë nga kategoria paraardhëse për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë personave që plotësojnë kriteret e posaçme dhe të përgjithshme të listuara në shpallje.

Në rast se në përfundim të afatit të dorëzimit të dokumentave, nuk ka kandidatë të tillë, atëherë procedura do të vijojë për kandidatët jashtë shërbimit civil, të cilët plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për pranimin në këtë kategori.

Për çdo procedurë aplikohet në të njëjtën kohë!

DATA E DORËZIMIT TË DOKUMENTAVE PËR LEVIZJE PARALELE: 6 shkurt 2023

DATA E DORËZIMIT TË DOKUMENTAVE PËR NGRITJE NË DETYRË / PRANIM NGA JASHTË SHËRBIMIT CIVIL: 10 shkurt 2023

Përshkrimi i punës:

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Organizon dhe mbikqyr procesin e menaxhimit dhe administrimit të spektrit të frekuencave audio/audioviziv.
- Mbikqyr dhe organizon procesin e administrimit të sistemeve të brendshme të menaxhimit të informacionit dhe administrimit të rrjetit.
- Administron dhe mbikqyr sigurinë fizike dhe informacionin e të dhënave në institucion.
- Mbikqyr zbatimin e rekomandimeve kombëtare dhe ndërkombëtare në lidhje me standartet teknike të transmetimeve audio/audiovizive dhe cilësinë e shërbimit audio/audioviziv.
- Propozon hartimin e akteve rregullatore në lidhje me menaxhimin e spektrit të frekuencave dhe teknologjinë e informacionit.

- Harton planin e punës dhe ndërton strategjinë në lidhje me realizimin e objektivave të vendosura dhe afateve të përcaktuara.
- Raporton në mënyrë periodike në instancat më të larta të institucionit në lidhje me punën e drejtorisë.
- Organizon dhe koordinon punën për hartimin e strategjisë për TIK, në përputhje me nevojat për kompjuterizimin/automatizimin e sistemeve të të dhënave në institucion.
- Harton dhe monitoron zbatimin e politikave të sigurisë së teknologjisë së informacionit në institucion.

I - Lëvizja paralele

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

1. Kushtet për lëvizjen paralele dhe kriteret e veçanta:

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori (kategoria II-b);
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- Të ketë vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor” për Inxhinieri Elektronike/Telekomunikacioni. Edhe diploma e nivelit Bachelor të jetë e të njëjtës fushë.
- Të ketë të paktën 3 vite eksperiencë pune në nivel të mesëm drejtues.

2. Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit:

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë njësisë së burimeve njerëzore të institucionit dokumentet si më poshtë:

- Kërkesë me shkrim;
- Jetëshkrim
- Fotokopje të diplomës; (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- Fotokopje të librezës së punës; (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- Vlerësimin e fundit nga eprorit direkt;
- Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 06 Shkurt 2023.

3. Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak:

Pas datës 6 shkurt 2023, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit do të shpallë në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive” dhe në faqen e internetit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit nëpërmjet adresave të e-mail, për shkaqet e mos kualifikimit.

4. Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista:

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuri në lidhje me Ligjin 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Njohuri në lidhje me legjislacionin e shërbimit civil;
- Njohuri në lidhje me Kodin e Procedurave Administrative;
- Njohuri në lidhje me vendimin Nr. 636, datë 29.07.2020, “Për miratimin e programit shumëvjeçar të politikës spektrale dhe të planit të veprimit”;
- Njohuri në lidhje me vendimin nr.434, datë 03.06.2020, “Për plani kombëtar për zhvillimin e qëndrueshëm të infrastrukturës digjitale broadband 2020–2025”;
- Njohuri në lidhje me vendimin nr.277, datë 29.03.2017, “Për miratimin e planit kombëtar të frekuencave”;
- Njohuri në lidhje me Marrëveshjet ndërkombëtare të koordinimit të frekuencave audio/audiovizive për Rajonin 1;
- Njohuri mbi Ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Njohuri mbi Ligjin nr. 9880, datë 25.2.2008 “Për nënshkrimin elektronik”, i ndryshuar;
- Njohuri mbi Ligjin nr. 10325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”;
- Njohuri mbi Ligjin nr.10273, datë 29.4.2010, “Për dokumentin elektronik”, i ndryshuar;
- Njohuri mbi Direktiva, rekomandime, standarde ndërkombëtare të ITU, CEPT etj;
- Njohuri mbi ligjin Nr. 9887, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

5. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:

Kandidatët do të vlerësohen për dokumentacionin e dorëzuar, përkatësisht për përvojë (20 pikë), trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse (10 pikë), si dhe vlerësimet për certifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë (10 pikë). Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen edhe në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve në përfundim të intervistës së strukturuar me gojë është 60 pikë.

6. Data e daljes së rezultateve të konkurrimit dhe mënyra e komunikimit:

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Autoriteti Mediave Audiovizive do të shpallë fituesin në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive” dhe në faqen zyrtare të AMA-s. Të gjithë

kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

II- Ngritja në detyrë/Pranim nga jashtë

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse (vetëm një kategori më e ulët), të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për vendin e lirë.

1. Kushtet që duhet të plotësojë kandidati janë:

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar;
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”;
- Niveli i diplomës duhet të jetë “Master Shkencor”. Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi.

2. Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor” për Inxhinieri Elektronike/Telekomunikacioni.
- b) Të kenë mbi 5 vjet përvojë pune në pozicione të kategorisë së pagës III-a, III-a/1 në fushën përkatëse; (për nëpunësin civil të kategorisë së ulët drejtuese);
- c) Të kenë mbi 10 vjet përvojë pune në fushën përkatëse në profesion (për nëpunësin jashtë shërbimit civil);
- d) Të ketë aftësi për të ofruar drejtim teknik, për të koordinuar, kontrolluar dhe vlerësuar veprimtarinë dhe përdorimin e burimeve në dispozicion.
- ç) Aftësi shumë të mira komunikimi dhe prezantimi.

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë njësisë së burimeve njerëzore të Autoritetit të Mediave Audiovizive si më poshtë:

- a) Kërkesë me shkrim;
- b) Jetëshkrim
- c) Fotokopje të diplomës; (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- ç) Fotokopje të librezës së punës; (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- dh) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f) Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- g) Vlerësimin e fundit nga eprorit direkt ose vlerësimet e rezultateve individuale në punë;
- gj) Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;

3. Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak

Pas datës 10 shkurt 2023 njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit do të shpallë në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive” dhe në faqen e internetit listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e ngritjes në detyrë si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e ngritjes në detyrë dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht (nëpërmjet adresës së e-mail), për shkaqet e moskualifikimit.

4. Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet testimi dhe intervista

Kandidatët do të testohen me shkrim dhe gjatë intervistës me gojë për njohuritë mbi dokumentet e listuara në pjesën I, pika 4. Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen edhe në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

5. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;
- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;
- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë.

6. Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e komunikimit

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit do të njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail) si dhe do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”.

Kandidatët duhet të dorëzojnë të gjitha dokumentat e cituara më sipër me postë ose dorazi në Autoritetin e Mediave Audiovizive.

Adresa: Autoriteti Mediave Audiovizive, Rruga “Papa Gjon Pali II”, Nr. 15, 1010, Tiranë.